



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2018:023716

Datë: 01.03.2019

Numri i dokumentit: 00268501

**P.nr.345/17**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – Departamenti i Përgjithshëm,** gjyqtari i vetëm gjykues Mentor Bajraktari, me procesmbajtësen Nushe Kadrija – sekretare juridike pranë kësaj gjykate, në lëndën penale kundër të akuzuarit A.H., Komuna e Gjakovës, për shkak të veprës penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore-Departamenti përgjithshëm me numër PP.nr.511/2017 të datës 24.05.2017, pas mbajtjes së seancave të shqyrtimit gjyqësor me datë: 25.09.2018, 29.10.2018, 29.11.2018, 21.12.2018 dhe 17.01.2019, në prezencën e Prokurores së shtetit Mone Sylja, përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar A.K., si dhe të akuzuarit, **me datën 21.01.2019** mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datën 01.03.2019 e përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I akuzuari:**

**A.H.**, nga i ati M., e ëma M., e gjinisë F., data e lindjes..., Komuna e Gjakovës, ku edhe tani banon, i martuar baba i pesë fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, pensioner, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar-shtetas i Republikës së Kosovës, numër personal...

Në bazë të nenit 364 par.1 nënpar.1.3 të KPP-së,

**L I R O H E T N G A A K U Z A**

Sepse nga data e pavërtetuar e gjer me datën 05.12.2016, në shtëpinë e tij, Komuna e Gjakovës, me qëllim që ti sjell vetit pasuri në mënyrë të kundërligjshme, ka shfrytëzuar në mënyrë të paautorizuar energjinë elektrike, në atë mënyrë që gjatë kontrollit është konstatuar se njëtori elektrik me numër .... përmes kabllos 3x2.5 është lidhur në rrjetin elektrik, me këtë veprim energjia elektrike e shpenzuar nuk është regjistruar, gjendje kjo e konstatuar nga personat e autorizuar të K.-it, distrikti në gjakove, me dt. 07.12.2016, me ç ‘rast të dëmtuarës i ka shkaktuar dëm në vlerë prej 313.36 €uro.

Këso dore kishte për të kryer veprën penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së.

E dëmtuara: K.-Distrikti në Gjakovë, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civil.

Shpenzimet e procedurës penale bien në llogari të mjeteve buxhetore të gjykatës.

## **A r s y e t i m**

### 1. Ecuria e procedurës dhe fjala përfundimtare e palëve.

Prokuroria Themelore në Gjakovë-Departamenti i përgjithshëm, pranë kësaj gjykate ka ngritur aktakuzën me numër PP/II.nr.1861/2016, të datës 29.03.2017, kundër të akuzuarit A.H., Komuna e Gjakovës, për shkak të veprës penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së.

I akuzuari A.H., gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën është ngarkuar me aktakuzë.

Prokurorja e shtetit Mone Sylja, në fjalën e saj përfundimtare ka deklaruar se: gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor u vërtetua në tërësi se i akuzuari gjerë me tani nuk e ka pranuar fajësinë edhe përkundër faktit se gjatë këtyre shqyrtimeve është vërtetuar saktësisht se i njëjti është kryesi i kësaj vepre penale për faktin se të gjitha provat e elaboruara gjerë me tani kanë qenë kundërthënëse njëra me tjetrën dhe gjithmonë tani i akuzuari duke u munduar që ti ikë përgjegjësisë penale në një formë apo në formë tjetër tendencat janë jo të sakta të paraqitura nga ana e tij për faktin se kjo nuk donë koment vetëm dita kritike kur personat e autorizuar kanë shkuar në mënyrë të qetë dhe pa ndonjë të keqe duke kërkuar që të e verifikojnë rastin dhe tani arsyet se kinse ndaj tij ka mundur dikush të ja bëjë me çelim pa ndonjë arsyetim konkret duke paraqitur ashtu rastin pezull e që neve nuk duhet të ia falim besimin për faktin se po të ishte kryer kontrolli në ditën kritike edhe gjërat kishin me qenë ndryshe. Vetë fakti se lidhja është prezentë flet se atë ditë apo ditë më parë është keqpërdorur kjo nuk donë asnjë koment tjetër për faktin se po mos të kishte keqpërdorë nuk do të vendosej fare. Fjala e tij se ajo kabull nuk ka furnizuar ndonjë pajisje është një veprim i tij i pa arsyetuar për faktin se po të qëndronte ashtu ishte lejuar kontrolli. E potencoi faktin se arsyetimin e tij që para një viti ka qenë një kontroll dhe tani dyshon në atë se pse të vije edhe kontroll tjetër gjerë me tani nuk është e arsyetuar me ligj koha se kur munden personat e autorizuar me dyshimet e veta të bëjnë kontroll në shtëpinë e tij për faktin se një vit i ka 12 muaj e që keqpërdorimi mund të jetë një muaj, dy apo më shumë apo më pak, unë nuk di se çka duhet të ketë më tepër për pos se faktet dhe provat, fotot të cilat i janë bashkangjitur kësaj lënde flasin qartë për inkriminimin e veprës penale dhe flasin qartë dhe mirë se është dyshimi i mirë i bazuar se i njëjti është kryesi i kësaj vepre penale andaj në bazë të lartcekurave i propozoi gjykatës që të njëjtë ta shpall fajtor, ta dënoi sipas ligjit njëkohësisht të e obligoi edhe në shpenzimet e procedurës penale.

Përfaqësuesi i autorizuar i palës së dëmtuar K.-Distrikti në Gjakovë A.K. në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se: e mbështes në tërësi fjalën përfundimtare të prokurores së shtetit si palë e dëmtuar parashtrojmë kërkesën pasurore-juridike ndaj të akuzuarit.

I akuzuari A.H. në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se: mbes pranë parashtrësave të propozuara gjykatës nga provat e propozuara, si dhe pas dëgjimit të dëshmitarëve, u vërtetua se nuk ka prova me të cilat do të vërtetohej vepra penale e përshkruar në aktakuzë. Në fakt kabloja e këputur e rrymës që është prezantuar si provë, gjendet akoma aty, dhe e njëjta është e këputur, shumë kohë më parë, kur e kam prishur objektin, dhe me nuk ka qenë funksionale, nga të mësipërmet i propozoi gjykatës që të refuzoi aktakuzën e Prokurorisë Themelore në Gjakovë, ashtu që të më liroi nga vepra penale për të cilën akuzohem, kërkoj shpenzimet.

### 2. Konstatimet e gjyqtarit të vetëm gjykues

Pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit gjyqësor dhe administrimit të provave si dhe vlerësimit të tyre një nga një dhe në lidhje me provat tjera, konform nenit 361 të KPP, gjyqtari i vetëm gjykues konstatoi këtë gjendje faktike:

- se nuk është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se i akuzuari A.H. në mënyrë të kundërligjshme e ka përdor, devijuar, nxjerr ose përfituar nga ndonjë shërbim komunal që furnizohet nga ose përmes rrjetit përçues të rrymës apo rrjetit të shpërndarjes nga neni 320 të KPK-së, në mënyrën, kohën dhe vendin e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### 3. Provat e administruara gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor

Meqenëse i akuzuari A.H., nuk e ka pranuar fajësinë për kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet gjykata për vërtetimin e gjendjes faktike gjatë shqyrtimit gjyqësorë i ka administruar këto prova: ka dëgjuar dëshmitarët M.K., V. B. si dhe M.K., si dhe ka administruar provat materiale të propozuara nga palët dhe atë: procesverbali me numër 20761 i datës 05.12.2016 i K.-Distrikti në Gjakovë, fatura mbi kalkulimin e dëmit të shkaktuar së bashku me faturën për rikthimin e humbjeve me numër DGj... e datës 07.12.2016, foto-dokumentacioni që gjendet në shkresat e lëndës dhe atë prej nr. 3 deri në numrin 6, procesverbali me numër ... i datës 16.09.2015 i K.-Distrikti në Gjakovë, transaksioni në emër të konsumatorit M. H. për periudhën kohore 01.01.2008 deri me datën 31.12.2017, fotografia që gjendet në shkresat lëndës pas kundërshtimeve të bërë nga i akuzuari, që gjenden në shkresat e lëndës si dhe ka dëgjuar mbrojtën e të akuzuarit A.H..

#### 3.1 Deklaratat e dëshmitarëve

3.1.1 Dëshmitari M. K., gjatë shqyrtimit gjyqësorë ka deklaruar se: punoj në K.-Distrikti në Gjakovë, në sektorin teknik i kontrollit, më kujtohet se me datën 05.12.2016 kemi qenë në kontroll tek konsumatori A.H., së bashku me kolegen tim V.B., dhe aty kemi konstatuar se konsumatori ka pasur një kabëll 3x2.5 mm, të lidhur direkt nga rrjeti elektrik pra tek shtylla jashtë njëisorit elektrik, pra jashtë matjes, nga se nga kjo lidhje energjia elektrike nuk është regjistruar fare në njëisorë. Gjatë kontrollit në shtëpi ka qenë prezent vetë i akuzuari A. H., të cilit kur i kemi thënë se e keni një kabllo jashtë njëisorit i njëjti i revoltuar na ka thënë dilni jashtë dhe largohuni prej këtu dhe kur na ka larguar nga aty ne kemi përpiluar një procesverbal jahte oborrit nga se nuk na ka lënë i akuzuari dhe ne vetëm kemi fotografuar njëisorin dhe kabllon. Ai ka thënë se kabllo nuk më kujtohet a ka qenë e vendosur në shtyllë apo ka qenë e vendosur në shtëpi në mure dhe pas shikimit të fotografisë me nr.6 ai ka theksuar se ka menduar se ka qenë vendosur në shtyllë por pas shikimit të fotografisë shihet se është në konzoll, është në murr. Ai ka theksuar se nuk kemi mundur të verifikojmë se çka ka furnizuar kjo kabllo meqenëse nuk na ka lejuar konsumatori të bëjmë verifikimin edhe pse është obligim i yni. Ai ka theksuar se kabllo ka qenë jashtë njëisorit, ne nuk e kemi bërë eliminimin e kabllorit direkt që janë të lidhura. Dhe ne e kemi për obligim që rastet që nuk mund të eliminojmë kabllo ta njoftojmë kompaninë për eliminimin e sajë dhe nuk e di a është eliminuar kjo kabllo. Ai ka shtuar se nuk është bërë verifikimi në pjesën lartë ku ka qenë e lidhur kabllo në konzoll por vetëm kemi bërë fotografi. Ai ka theksuar se njëtori elektrik ka qenë i lidhur me një kabllo tjetër ndërsa kabllo që ka qenë e lidhur jashtë njëisorit nuk e kemi verifikuar se çka ka furnizuar por me siguri ka furnizuar diçka dhe konkretisht nuk e di meqenëse kabllo ka qenë e lidhur në shtyllë dhe ka qenë e hyrë në shtëpi një pjesën ku ka shkuar dhe çka ka bërë nuk e di. Kur e kemi verifikuar kabllon që kishte njëtori me kabllon tjetër kur e kemi ndalë fidin tek njëtori kemi parë kabllon tjetër dhe kemi thënë se kjo kabull është jashtë njëisorit por nuk e kemi kuptuar se kjo kabull çka ka furnizuar.

3.1.2 Dëshmitari V.B., gjatë shqyrtimit gjyqësorë ka deklaruar se: punojë në K.-Distrikti në Gjakovë, si teknik i kontrollit, me datën 05.12.2016, kemi qenë në kontroll tek konsumatori A.H., Komuna e Gjakovës, së bashku me M. K., atë ditë kemi qenë në kontroll tek e njëjta trafo e daljes pra ka qenë në kontroll në bazë të një liste ashtu që kemi hyrë në shtëpinë e konsumatorit A.H. dhe për fillim unë kam fotografuar njëisorin dhe gjatë kontrollit kemi hasur në një kabllo 3x3.5 e cila ka qenë e lidhur në konzoll pra ka qenë në murrë pastaj konsumatori na ka larguar prej oborrit pasi që ne kemi dashur të verifikonim se ku shkon kjo kabllo por nuk na ka lejuar ashtu që ne vetëm kemi fotografuar kabllon dhe na ka larguar nga oborri kështu që nuk na ka lejuar të bëjmë kontrollin e mirëfilltë. Kabllo ka qenë e lidhur jashtë njëisorit. Por nuk e di se ku ka shkuar kjo kabllo nga se nga konzolla ka hyrë lartë në shtëpi por nuk kemi mundur ta verifikojmë se ku ka shkuar. Konsumatori ka qenë në shtëpi dhe pasi që kemi fotografuar kabllon e cila ka qenë jashtë njëisorit dhe nuk kemi mundur të verifikojmë se çka ka furnizuar m brenda. Kabllo ka qenë e vendosur në murr të shtëpisë tek konzolla, ka qenë 4 deri 5 metra lartë pra përfundi kulmit. Ai ka theksuar se ne nuk kemi mundur ta verifikojmë se a ka pasur energji përkatësisht rrymë kjo kabllo meqenëse nuk e kemi matur dhe theksoi se nuk e dimë se kjo kabllo a ka qenë aktive nga se theksova se na ka larguar nga shtëpia nuk e kemi matë dhe nuk e dimë çka ka furnizuar kjo kabllo. Ai ka theksuar se nuk jemi ngjitur lartë në konzoll që të e vërtetojmë se si ka qenë e lidhur kjo kabllo meqenëse konsumatori na ka larguar nga shtëpia. Ai ka shtuar se nuk e kemi bërë eliminimin e kësaj kabllo dhe për këtë e kemi dorëzuar procesverbalin M. K., i cili ka qenë koordinator i yni. Nuk e di se a është bërë eliminimi i kësaj kabllo nga ana e kompanisë edhe pse është obligim i yni që të e eliminojmë por meqenëse konsumatori neve nuk na ka lejuar ne nuk e kemi eliminuar. Ai ka shtuar se unë po theksoi se kabllo ka pasur energji dhe këtë e them vetëm në atë çka kam parë se kabllo ka qenë e lidhur direkt në konzoll me sytë e lirë, ai ka theksuar se në rastet kur na largojnë konsumatorët ne kemi të drejtë të kërkojmë asistencë nga policia por nuk e kemi kërkuar.

3.1.3 Dëshmitari M.K., gjatë shqyrtimit gjyqësorë ka deklaruar se: punojë në K.-Distrikti në Gjakovë, si zyrtar dhe jam si inxhinier i prishjeve. Kam qenë edhe koordinator i ekipeve të kontrollit për humbje për ekipet komerciale por datën nuk e mbaj mend dhe atë prej fillimit të vitit 2015 gjerë në vitin 2018 por si datë nuk më kujtohet. Pas shikimit të procesverbalit të datës 15.02.2016 të përpiluar nga dëshmitarët M. K. dhe V. B., ai ka deklaruar se ne këso raste kemi pasur shumë por ky raste më kujtohet si specifikë për faktin se kontrollorët nuk i janë lejuar që të bëjnë kontroll. Ai ka shtuar se nga ana ime nuk është urdhëruar që të bëhet eliminimi i kësaj kabllo mirëpo nga ekipi i kontrollës apo nga përgjegjësit e terrenit jam njoftuar se konsumatori vetë e ka ç'kyçur kabllon ilegal. Më sa më duket është dërguar një ekip për eliminimin e kësaj kabllo mirëpo nuk kemi ndonjë procesverbal me shkrim dhe nuk më kujtohet se cilin kontrollorë e kemi dërguar. Ai ka shtuar se është obligim që nëse një kabllo është e lidhur direkt ti ndërmerim veprimet për eliminimin e sajë dhe duhet të veprohet sa më shpejtë që është e mundur. Në rastin konkret në bazë të asaj që ka munguar procesverbali ne jemi njoftuar verbalisht se kabllo ka qenë i eliminuar por nuk e di saktësisht se nga kush jam informuar.

### 3.2 Provat materiale

3.2.1 Nga leximi i procesverbali me numër 20761 i datës 05.12.2016 i K.-Distrikti në Gjakovë, mbi gjendjen e njëisorit gjykata ka konstatuar se gjatë kontrollit dëshmitarët M. K. dhe V.B., në këtë procesverbal kanë konstatuar se kanë vërejtur një kabull 3x2.5mm, e cila është anashkaluar por konsumatori nuk na lejoi që të hiqet keqpërdorimi dhe nuk na lejoi që të merrem fuqia e prishjeve teknike dhe nuk na lejoi që të merret gjendja në njëisorë e konsumatorit, konsumatori me dhunë na dëbon.

3.2.2 Nga leximi i faturës mbi rikthimin e humbjeve në emër të konsumatorit M. H. të datës 07.12.2016, gjykata ka konstatuar se me anë të kësaj fature është bërë llogaritja dhe faturimi i shpenzimeve të pa autorizuara

3.2.3 Nga leximi i fatura mbi kalkulimin e dëmit të shkaktuar së bashku me faturën për rikthimin e humbjeve me numër DGj... e datës 07.12.2016, gjykata ka konstatuar se me anë të kësaj fature është përcaktuar rikthimi i humbjeve nga ana e K.-it.

3.2.4 Nga shikimi procesverbali me numër... i datës 16.09.2015 i K.-Distrikti në Gjakovë, gjykata ka konstatuar se tek konsumatori M. A. H., ishte bërë një kontroll paraprak nga K.-Distrikti në Gjakovë dhe nuk kishte pasur ndonjë dyshim.

3.2.5 Nga shikimi i transaksioni në emër të konsumatorit M. H. për periudhën kohore 01.01.2008 deri me datën 31.12.2017, gjykata ka konstatuar se shihen shpenzimet e energjisë elektrike tek konsumatori me emrin M.H., në të cilin evidentohet ende njëtori elektrik por që janë shpenzimet e energjisë elektrike për të akuzuarin A.H..

3.2.6 Nga shikimi i foto-dokumentacioni që gjendet në shkresat e lëndës dhe atë prej nr. 3 deri në numrin 6, gjykata ka konstatuar se në këto fotografi shihet njëtori dhe shihet pjesa e konzullit dhe kabllot.

### 3.3 Mbrojtja e të akuzuarit

3.3.1 I akuzuari A.H., gjatë shqyrtimit gjyqësorë nuk e ka pranuar fajësinë ndërsa gjatë mbrojtjes së tij ka deklaruar se: nuk e ndjen veten fajtor për veprën penale për të cilën ngarkohet sepse ditën kritike kanë ardhur kontrolloret e K.-it se dhe të njëjtit më kanë thënë se duam të kontrollojmë. Iu kam drejtuar se pse po dëshironi me më kontrollua kur ende se keni një vit që keni bërë kontroll në shtëpinë time dhe kam thënë se nuk ju lë që të bëni kontroll merrni policin dhe pastaj hajdeni këtu dhe ju lë të kontrolloni nga se unë kam dyshuar në kontrolloret e K.-it. Nuk kam folur asgjë me ta ata vetëm kanë fotografuar kabllon dhe kanë dalë jashtë nga se ata më thanë se ne po dyshojmë tek kjo kabëll dhe i kam thënë fotografone kabllon dhe dilni përjashta nga se iu kam thënë se po dyshoi në juve dhe nëse doni thirni policinë dhe më pastaj askush nga punëtorët e K.-it nuk kanë ardhur dhe kabllon është në të njëjtën gjendje siç ka qenë dhe qysh në fillim kam thënë se atë kabëll nuk e preki derisa të përfundoi ky rast nga se shtëpia ku shihet kabllon është tërësisht e pa banueshme. Prandaj edhe nuk e ndiej vetën fajtor nga se nuk ka qenë kabllon e lidhur ditën kritike por ajo kabllon ka qenë e lidhur shumë kohë më parë dhe ka qenë e lidhur oda dhe kur është prishë oda ajo kabllon është këputur dhe ka mbetur ashtu dhe e njëjta edhe sot është në të njëjtën dhe ajo kabllon ka qenë e eliminuar dhe ka qenë e futur dhe nuk ka pasur mundësi tjera të eliminoi ajo ka qenë jashtë funksionit dhe nuk ka funksionuar asgjë dhe sot ekziston kështu, kabllon ka qenë i këputur dhe nuk ka paraqitur asnjë rrezik. Ai ka theksuar se kontrolloret e K.-it nuk e kanë kontrolluar kabllon por vetëm e kanë fotografuar dhe janë larguar. Ajo nuk ka pasur energji dhe nuk është furnizuar asnjë mjetë me atë kabllon.

### 4. Elementet e veprës penale

Në nenin 320 të KPRK, është parashikuar se veprën penale vjedhje e shërbimeve komunale e kryejnë: “Kushdo që merr, përdor, devijon, nxjerr ose përfiton nga ndonjë shërbim komunal që furnizohet nga ose përmes rrjetit përçues të rrymës apo rrjetit të shpërndarjes, pa autorizimin e furnizuesit të autorizuar, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet”. Pra kryesi i kësaj vepre penale mund të jetë çdo person, ku nënkuptohet edhe personat. Veprimet me të cilat kryhet kjo vepër penale janë paraqit në mënyrë alternative si vijon: me

marrjen e pa autorizuar të shërbimit komunal, me përdorimin e pa autorizuar të shërbimit komunal, me devijimin e pa autorizuar të shërbimit komunal, me nxjerrje ne pa autorizuar të shërbimit komunal dhe përfitimi i pa autorizuar nga shërbimi komunal që furnizohet nga ose përmes rrjetit përçues të rrymës apo rrjetit të shpërndarjes. Vepra penale kryhet vetëm me dashje përgjegjës ose të autorizuar.

### 5. Vlerësimi dhe analizimi i provave

Gjykata pasi që ka analizuar të gjitha provat në rastin konkret ka konstatuar se me date 23.05.2016, fillimisht kontrollorët e K.-it, këtu dëshmitarët M.K. dhe V.B.kishin pasur për detyrë që ti kontrollojnë konsumatorët, ashtu që në të njëjtën ditë kanë shkuar që të bëjnë kontroll edhe në shtëpinë e të akuzuarit A.H..Meqenëse atë ditë kontrollorët e K.-it, gjatë kontrollit në shtëpinë e të akuzuarit kanë vërejtur se ekziston një kablo e vendosur në konzull (mur) të shtëpisë, kishin dyshuar se i akuzuari A.H. është duke e keqpërdorur energjinë elektrike, duke dyshuar se blomba kishte qenë jashtë njësorit dhe pasi që i kishin thënë të akuzuarit A.H. i cili kishte qenë prezentë se kjo kablo është jashtë njësorit, i njëjti i kishte larguar kontrollorët-këtu dëshmitarët nga shtëpia e tij me dhunë ashtu që dëshmitarët M.K.dhe V. B.nuk kanë bërë ndonjë kontrolle tjetër rreth kësaj kabllor, por vetëm e kanë bërë fotografinë e saj dhe janë larguar nga shtëpia e të akuzuarit duke përpiluar procesverbalin e datës 05.12.2016 jashtë oborrit të shtëpisë së të akuzuarit në të cilin kishin konstatuar se konsumatori ka qenë i lidhur direkt jashtë njësorit edhe pse të njëjtit nuk kanë bërë kontrollin e kësaj kabllor ditën kritike se si ka qenë e lidhur direkt, nuk kanë bërë matjen se a ka pasur energji dhe po ashtu nuk kanë konstatuar se çka ka furnizuar kjo kablo, a ka furnizuar ndonjë pajisje elektrike, por të njëjtit vetëm kanë bërë fotografimin e saj dhe janë larguar nga shtëpia e të akuzuarit edhe pse kanë qenë të obliguar që ti marrin këto veprime qoftë atë ditë apo më vonë. Kjo gjendje është vërtetuar nga vetë dëshmia e dëshmitarit M. K., të cilit gjykata i ka falur pjesërisht besimin dhe atë vetëm në pjesën kur ka deklaruar “se kabllon nuk e kemi verifikuar se çka ka furnizuar nga se nuk na ka lejuar konsumatori të bëjmë verifikimin edhe pse ka qenë obligim i jonë ashtu që nuk e kemi bërë verifikimin në pjesën lartë ku ka qenë e lidhur kablo në konzull por vetëm kemi bërë fotografinë e saj”. Kësaj pjese të dëshmisë së dëshmitarit M.K., gjykata ia ka falur besimin për faktin se është në harmoni edhe me deklaratën e dëshmitarit V. B., të cilit gjykata po ashtu ia ka falur pjesërisht besimin dhe atë vetëm në pjesët ku ka deklaruar se: *kablo ka qenë e vendosur në shtëpi 4-5 metra lartë përfundim kulmit dhe nuk kemi mundur ta verifikojmë se a ka pasur energji përkatësisht rrymë kjo kablo, meqenëse nuk e kemi matur dhe nuk e dimë se kjo kablo a ka qenë aktive nga se na ka larguar nga shtëpia i akuzuari dhe nuk e kemi matë dhe nuk e dimë se çka ka furnizuar*”. Gjykata këtyre pjesëve të deklaratave të dëshmitarëve të lartpërmendur iu ka falur besimin për faktin se janë në harmoni edhe me mbrojtjen e të akuzuarit A.H. i cili ka deklaruar se: “Nuk kam folur asgjë me ta, ata vetëm kanë fotografuar kabllon dhe kanë dalë jashtë nga se ata më thanë se ne po dyshojmë tek kjo kabell dhe i kam thënë fotografone kabllon dhe dilni përjashta nga se iu kam thënë se po dyshoj në juve dhe nëse doni thirrni policinë dhe më pastaj askush nga punëtorët e K.-it nuk kanë ardhur dhe kablo është në të njëjtën gjendje siç ka qenë dhe qysh në fillim kam thënë se atë kabell nuk e preki derisa të përfundoi ky rast nga se shtëpia ku shihet kablo është tërësisht e pa banueshme”. Prandaj gjykata ia ka falur besimin e plotë të akuzuarit A.H.i cili ka mohuar kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet, e i cili ka deklaruar se “kjo kablo ka qenë qysh prej shumë kohë më parë dhe në këtë kablo ka qenë e lidhur oda dhe kur është prishë oda ajo kablo është këputur dhe ka mbetur ashtu dhe e njëjta edhe sot është në të njëjtën gjendje dhe ajo kablo ka qenë e eliminuar dhe nuk ka pasur mundësi tjera të eliminimit për shkak se ka qenë jo funksionale dhe kjo kablo ka qenë e këputur dhe nuk ka paraqitur asnjë rrezik dhe nuk ka pajisur asnjë pajisje elektrike”.

Gjykata nuk ka mundur të ia falë besimin provës përkatësisht procesverbalit mbi gjendjen faktike me numër 276108 të datës 05.12.2016, e cila është përpiluar nga dëshmitarët M.K.dhe V.B., në të cilën kishin konstatuar se një kablo 3x2.5 mm, është anashkaluar por konsumatori nuk na lejon të heqim keqpërdorimin, për faktin se nuk ishte bërë kontrollimi i duhur dhe ky konstatim ka qenë i pa mbështetshëm edhe me deklaratimet e tyre të dëgjuar në cilësi të dëshmitarëve. Po ashtu nuk ka mundur të ia falë besimin pjesëve të deklaratave të dëshmitarëve V.B.dhe M. K., kur kanë deklaruar se *“kablo ka qenë e lidhur direkt jashtë njësorit”*, për faktin se gjykata vlerëson se dëshmitarët janë punëtor tek e dëmtuara K. dhe këto deklarime i bëjnë për shkak mbrojtjes së interesit të kompanisë së tyre ku punojnë me meqenëse e dëmtuara K. është punëdhënësi i tyre. Po ashtu deklarimet e tyre në këtë pjesë janë supozuese-deklarative të pa mbështetshme në prova, gjithashtu janë edhe kontradiktore me pjesët e deklaratimeve të cilave gjykata iu ka falur besimin për faktin se të njëjtit ditën kritik kur kanë bërë kontrolle tek i akuzuarit A. H., që të dy kanë deklaruar se nuk kanë bërë verifikimin e kabllot dhe nuk kanë bërë matjen se a ka pasur energji elektrike kablo dhe po ashtu nuk kanë verifikuar faktin se çka ka furnizuar kjo kablo, nuk kanë bërë eliminimin e saj edhe pse kanë pasur për obligim, por vetëm kanë bërë fotografimin e kësaj kabllot dhe nuk kanë ndërmarr masa tjera qoftë edhe për të lajmëruar rastin në polici pra nuk kishin bërë një kontrollë të detajuar. Prandaj edhe gjykata nuk ka mundur të iu falë besimin kur kanë deklaruar se kablo ka qenë e lidhur direkt nga se edhe vetë dëshmitari V.B. ka theksuar *“nuk kemi mundur ta verifikojmë se a ka pasur energji përkatësisht rrymë kjo kablo, meqenëse nuk e kemi matur dhe nuk e dimë se kjo kablo a ka qenë aktive nga se na ka larguar nga shtëpia i akuzuari dhe nuk e kemi matë dhe nuk e dimë se çka ka furnizuar.”* Sa i përket dëshmisë së dëshmitarit M. K. po ashtu punëtor i K. – distrikti në Gjakovë, gjykata dëshminë e tij e ka vlerësuar si irelevante për çështjen për faktin se dëshmia e tij nuk ka qenë e qartë meqenëse të njëjtit i kujtohet si rast se ishte njoftuar nga kontrolloret e tij që i kishte në menaxhim në atë kohë për largim nga konsumatori por nuk i kujtohen emrat e personave të cilët e kanë njoftuar se është bërë eliminimi i kësaj kabllot, meqenëse deklarata e tij është edhe në kundërshtim edhe me mbrojtjen e të akuzuarit i cili ka deklaruar se *“deri më sot asnjëri nga punëtorët e K.-it nuk e kanë eliminuar këtë kablo dhe është në të njëjtën gjendje.”*

Duke pas parasysh të gjitha këto rrethana, fakte të shqyrtuara dhe me provat e vërtetuara, gjykata morri aktgjykim lirues për faktin se aktakuza ka mbetur në nivelin e dyshimit të arsyeshëm dhe jo të bazuar mirë në prova të artikulueshme dhe të besueshme se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën ngarkohet ngase edhe vet prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare ka theksuar *“se është vërtetuar se i akuzuari ka kryer veprën penale për faktin se të gjitha provat e elaboruara gjerë me tani kanë qenë kundërthënëse njëra me tjetrën, dhe gjithmonë i akuzuari duke mundur të i ikë përgjegjësisë penale në një formë apo formë tjetër, janë tendenca jo të sakta të paraqitura nga ana e tij për faktin se personat e autorizuar kanë shkuar në mënyrë të qetë që të verifikojnë rastin dhe arsyeja e tij se kinse dikush po e bënë me qellim pa ndonjë arsye konkrete ashtu që rastin e ka lënë pezull e që nuk duhet ti falet besim dhe vetë fakti i lidhjes është prezentë se ditën kritike apo ditë më parë është keqpërdorë, kjo nuk do të thotë asnjë koment tjetër për faktin se po të mos ishte keqpërdorë nuk do të vendosej fare”* andaj gjykata ka ardhur në përfundim se ky pretendim i prokurorisë se është vërtetuar se i akuzuari ka kryer veprën penale nuk qëndron ngase vetë në fjalën përfundimtare të saj ka theksuar se provat janë kundërthënëse dhe se me prova kundërthënëse nuk ka mundur të vërtetohet gjendja faktike dhe po ashtu gjykata ka ardhur në përfundim se me të gjitha provat e administruara nuk është vërtetuar fakti se si akuzuari përmes kësaj kabllot kishte qenë i lidhur direkt në rrjetin elektrik dhe me këtë veprim energjia elektrike nuk është regjistruar, prandaj nuk ka mundur të vërtetojë faktin se i akuzuari ta ketë përdorë apo shfrytëzuar kabllon dhe t’i ketë shkaktuar dëmin të dëmtuarës siç pretendohet me akuzë ngase edhe me vetë dëgjimin e dëshmitarëve të propozuar nga prokuroria gjykata nuk ka mundur të vërtetojë se i akuzuari këtë kablo e kishte shfrytëzuar-përdorur ngase dëshmitarët M.K.dhe V.B. që të dy kanë deklaruar

se: nuk kanë verifikuar se a ka pasur energji përkatësisht rrymë kjo kablo, nuk e kanë matur dhe nuk e kanë vërtetuar se kjo kablo a ka qenë aktive nga se i kishte larguar nga shtëpia i akuzuari dhe nuk e kanë konstatuar se çka ka furnizuar kjo kablo, prandaj edhe gjykata nuk ka mundur të vërtetojë se a ka qenë e lidhur direkt, a e ka shfrytëzuar i akuzuari këtë kablo dhe a ka pasur energji elektrike kur nuk është bërë kontrolli detal i kësaj kablo nga ana e dëshmitarëve të lartpërmendur, prandaj pretendimi se ai më parë ka mundur ta ketë keqpërdorë-shfrytëzuar duke i furnizuar pajisjet elektrike, gjykata duke u bazuar në parimin “*IN DUBIO PRO REO*” nenin 3 par.2 të KPP-së, në cilin është përcaktuar se “*mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal interpretohen në favor të të pandehurit dhe të drejtave të tij sipas këtij Kodi dhe sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës*”, në mungesë të provave duke u bazuar në nenin 364 par.1 pika 1.3 të KPP, të akuzuarin A.H. e ka liruar nga akuza për veprën penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 paragrafi 1 të KPRK-së, të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit.

#### 6. Vendimi për lirimin e të akuzuarit nga akuza

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart dhe në nenin 364 par.1 nënpar.1.3 të KPP gjyqtari i vetëm gjykues e liroi nga akuza të akuzuarin S. S., për kryerjen e veprës penale, siç është cekur në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

#### 7.Vendimi lidhur me kërkesën pasurore-juridike

Vendimi mbi udhëzimin e palës së dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike në kontest civil është marrë në kuptim të dispozitës së nenit 463 par.3 të KPP-së.

#### 8. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë duke u bazuar nenin 454 par.1 të KPP-së.

Duke u bazuar në arsyet që u cekën më lartë, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË**  
**- Departamenti i përgjithshëm -**  
**P.nr.345/17, me datë 21.01.2019**

**Procesmbajtësja,**  
**Nushe Kadrija**

**Gjyqtari i vetëm gjykues,**  
**Mentor Bajraktari**

**UDHËZIMI JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh pas marrjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.